

Syllabusi i lëndës

Të dhëna bazike të lëndës:

Lënda:	Fik`hu Ibadat - I -
Programi i studimit:	Studime Islame
Numri i ECTS kredive:	6
Statusi i lëndës:	Obligative
Kodi i lëndës:	102
Fondi i orëve:	3+2
Viti akademik:	2026-2027
Semestri:	i -I-rë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Ilmije KUQI
Detajet kontaktuese:	ilmijekuqi1@gmail.com

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Fikhu, si shkencë e dispozitave ligjore në sistemin juridik islam, përfaqëson një disiplinë themelore që rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse aspektet e jetës private dhe publike të besimtarëve myslimanë. Kjo shkencë e veçantë ka një rol të rëndësishëm në formësimin dhe udhëzimin e jetës së përditshme të myslimanëve, duke ofruar udhëzime të qarta dhe të detajuara për çdo aspekt të jetës së tyre. Në mesin e kësaj shkence gjendet edhe Fikhu Ibadati, një degë e specializuar që merret me studimin dhe shpjegimin e pesë shtyllave kryesore të Islamit. Këto shtylla përfshijnë: pastërtinë, namazin, zekatin, agjërimin dhe haxhin. Në kuadër të kësaj lënde, një vëmendje e veçantë i kushtohet dy aspekteve themelore: pastërtisë dhe namazit. Këto dy aspekte analizohen në detaje të thella për të siguruar kryerjen e tyre në përputhje të plotë me mësimet e Kuranit dhe traditën profetike të Sunetit.

Qëllimi i lëndës

- Forcimi i marrëdhënieve të studentit me Krijuesin e tij përmes mëimit të rregullave të adhurimit.
- Njohja e rëndësisë së aspektit praktik të fesë, veçanërisht të ibadeteve (adhurimeve), të cilat janë shtylla të fesë Islame.
- Njohja e ibadeteve, normave dhe kushteve të tyre, si dhe çdo aspekti që lidhet me to, me qëllim që studenti të jetë i avancuar në njohuritë e fesë dhe i vetëdijshëm për zbatimin e normave të saj.
- Përmirësimin e moralit si dhe kultivimi i virtyteve të larta njerëzore, duke përfshirë: bindjen ndaj Zotit, organizimin e jetës sipas parimeve fetare, pastërtinë shpirtërore dhe fizike, lutjen dhe përkushtimin.
- Lidhja e ngushtë e studentit me burimet themelore doktrinare të fesë islame dhe përfitimi maksimal prej tyre.

- Angazhimi i mendjes kritike në procesin e njohjes dhe nxjerrjes së normave të Legjislacionit Islam (Sheriatit) nga burimet kryesore: Kurani dhe Suneti i mendjeve për njohjen - nxjerrjen e normave të Legjislacionit Islam nga Kur`ani dhe Suneti.
- Aftësimi i studentëve për të kuptuar dhe zbatuar parimet themelore të jurisprudencës islame në jetën e përditshme.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje:

- Të përshkruajë arritjet në njohjen e dispozitave praktike të Legjislacionit Islam.
- Të krahasojë në mënyrë analitike dispozitat praktike që lidhen me detyrimet fetare të besimtarëve.
- Të diskutojë me kompetencë rreth këndvështrimeve të ndryshme të dijetarëve islamë për çështjet e trajtuara gjatë kursit.
- Të mbrojë qëndrimet e tij duke u bazuar në argumente të shëndosha dhe bindëse nga burimet autentike.
- Të prezantojë me saktësi bazat dhe përfundimet e shkollës juridike (medh'hebit) që ndjek.
- Të demonstrojë aftësi në zbatimin praktik të njohurive të fituara gjatë studimeve në jetën e përditshme.

Metodologjia e mësimdhënies:

Procesi i mësimdhënies zhvillohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse që kombinon ligjëratat teorike me diskutime aktive në klasë. Studentet inkurajohen për pjesëmarrje përmes analizave kritike dhe debateve konstruktive, duke krijuar një mjedis të hapur për shkëmbimin e ideve. Punimet seminarike semestrare shërbejnë si një komponent thelbësor i procesit mësimor, duke u dhënë studentëve mundësinë për të demonstruar njohuritë e tyre në mënyrë të pavarur. Marrëdhënia midis studentëve dhe profesorëve karakterizohet nga një komunikim i hapur dhe transparent, duke mundësuar udhëzime të vazhdueshme për arritjen e objektivave akademike.

Përmbajtja e lëndës:

Nr.	Java	Ligjëratat
1.	Java I	Njoftim i përgjithshëm me lëndën, literaturën, vlerësimin e studentëve, etj, si dhe tema: Abdesi.
2.	Java II	Gusli dhe tejemumi,
3.	Java III	Mes'hi mbi meste dhe mbi fashë.
4.	Java IV	Hajdi, nifasi dhe istihada.

5.	Java V	Namazi dhe kohët e tij.
6.	Java VI	Kushtet e namazit dhe vaxhibet e tij.
7.	Java VII	Sunetet e namazit dhe namazi me xhemat.
8.	Java VIII	Gjërat që e prishin namazin
9.	Java IX	Mekruhet e namazit.
10.	Java X	Namazi i vitrit dhe i nafileve.
11.	Java XI	Namazi i teravive dhe namazi kaze.
12.	Java XII	Sehvi sexhdeja dhe sexhdetu tilaveti.
13.	Java XIII	Namazi i të sëmurit dhe i udhëtarit.
14.	Java XIV	Namazi i xhumasë dhe i bajrameve.
15.	Java XV	Namazi i xhenazes.

Provimi përfundimtar

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 10%

Testi intermedier 40%

Provimi final 40%

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të respektojë institucionin dhe rregullat e parapara:

- të respektojë orarin e ligjëratave;
- të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi;
- të mos mbajë të kyçur celular, apo aparate tjera gjatë orëve të mësimi.

Literatura obliguese:

1. Margaritari në detin e Fikhu Ibadatit, Ilmije Kuqi, Prishtinë 2021.
2. Fik'hu Hanefi, Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, Zurch 2011.

3. Bedai es-Senai, Ebu Bekr bin Mesud el-Kasani, Kairo 2005.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Çështjet e Fikhut sipas Kuduriut, Muhamed Ashik Ilahi el – Bureni, Prishtinë 2002.
2. Fik'hu el-Hanefi el-Mujessir, Vehbe ez-Zuhejli, darul-fikr 2010.

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktime me mësimdhënësin\konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren	-	-	-
Kollokfiume, seminare, ese	1	10	10
Detyra të shtëpisë	1	20	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	30	30
Përgatitja përfundimtare për provim.	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	2	5	10
Totali	16	15 javë	175